



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obština-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

KONTRATË

Data: 27 / 04 / 2023

KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe
" MBB Construction SH.P.K., rr. Caralevës, nr.81,, Prizren, (në vazhdim "Furnizuesi"), dhe me nr të regjistrimit e biznesit unik 810080432 e përfaqësuar nga Kushtrim Bajrami-drejtor, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për furnizimet e shënuara me poshtë:

Titulli: Renovimi dhe Invertarizimi i Shoqatës Qendrore te Personave te Shurdhër
Renovimi i Shoqatës Qendrore te Personave te Shurdhër LOT 1

Nr i prokurimit	616-22-12893-5-2-1
Nr i brendshëm	616 22 191 521

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit:

Renovimi i Shoqatës Qendrore te Personave te Shurdhër LOT 1

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i punëve duhet të jetë: **43,206.50€**; [Katerdhjet e tre mije e dyqinde e gjashte euro e pesedhjet euro cent/ .

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

Marrëveshja e kontratës;

Kushtet e Veçanta të Kontratës;

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;

Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.





Neni 4 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën Shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues		Për Kontraktuesin	
Emri:	Visar Shehu	Emri:	KUSHTIN BASHANI
Pozita:	Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit	Pozita:	DREKTOR
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	27.04.2023	Data:	27.04.2023
Vula:		Vula:	

KUSHTET E PËRGJITHSHME

Numri i kontratës: 616-22-3432-5-2-1/C832

Neni 1 Përkufizimet

1.1 “Kontratë” do të thotë marrëveshje të lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Kontraktuesit, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.

1.2 “Punë” konsiderohen të gjitha ato punë të cilat janë objekt i kontratës dhe të cilat Autoriteti Kontraktues kërkon që të kryhen nga kontraktuesi, qofshin ato ndërtim, restaurim, meremetim apo rrënim ndërtesash, pajisje, struktura inxhinieringu civil, struktura të tjera apo pjesë të tyre.

1.3 “Kontraktuesi” është operatori ekonomik (apo grupi i operatorëve ekonomik), i caktuar në formularin e kontratës, i cili (të cilët) është palë në kontratë dhe është i obliguar të kryejë punët sipas marrëveshjes dhe i cili do të marrë shumën sipas marrëveshjes me kontratë.

1.4 “Menaxheri i Projektit” është njeriu i caktuar në kushtet e veçanta të kontratës (apo cilido njeri kompetent i autorizuar nga Autoriteti Kontraktues), i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së punëve dhe për të gjitha hollësitë duhet t’i raportojë Autoritetit Kontraktues.

1.5 “Çmimi Kontratës” do të thotë shuma që i paguhet Kontraktuesit sipas marrëveshjes në formularin e kontratës.

1.6 “Vendi i ndërtimit” do të thotë vendi i caktuar për kryerjen e punëve të kontraktuara.

1.7 “Pajisjet e kontraktuesit” do të thotë e tërë makineria përfshirë edhe atë për bartjen e pajisjeve, dhe mjetet tjera që nevojiten për kryerjen e punëve të kontraktuara që duhet të bëhen sipas kontratës.

1.8 “Skicat” nënkuptojnë vizatimet, llogaritjet, informatat e siguruara dhe të miratuara nga Autoriteti Kontraktues për kryerjen e punëve të kontraktuara.

1.9 “KPK” do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 “KVK” do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Kontraktuesi e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Kontraktuesi nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Kontraktuesit, të shumave që duhet të paguhën ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Kontraktuesit siguruesve të Kontraktuesit për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Kontraktuesit.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Kontraktuesin nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Kontraktuesi ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit të ofertës. Ne rast të ndryshimit të nënkontraktuesve gjatë implementimit të kontratës, Kontraktuesi duhet të njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Kontraktuesin për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Kontraktuesi nuk nënkontraktion pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet të përmbushin kërkesat e përshtatshmërisë.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeh lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideron si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Kontraktuesi është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Kontraktuesit, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Menaxherit të Projektit nuk e liron Kontraktuesin nga obligimet e tij sipas kontratës

4.5 Nëse nënkontraktuesi ka marrë ndonjë obligim të vazhdueshëm që vazhdon për një periudhë që e tejkalon atë të periudhës së garancisë nën kontratë ndaj Kontraktuesit, përkitazi me furnizimet që i jep nënkontraktuesi, Kontraktuesi duhet që, në çfarëdo momenti pas skadimit të periudhës së garancisë, t'i transferojë menjëherë te Autoriteti kontraktues, me kërkesë dhe shpenzime të Autoritetit kontraktues, përfitimet e obligimeve të tilla për kohëzgjatjen e garancisë së skaduar.

OBLIGIMET E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Neni 5 Dhënia e dokumenteve

5.1 Nëse është e nevojshme, brenda 30 ditësh nga nënshkrimi i kontratës, autoriteti kontraktues duhet t'i japë Kontraktuesit, pa pagesë, një kopje të skicave të përgatitura për realizimin e kontratës dhe kopje të specifikimeve dhe dokumenteve tjera të kontratës. Kontraktuesi mund të blejë kopje tjera të këtyre skicave, specifikimeve dhe dokumenteve tjera, në rast se ato janë në dispozicion. Pas lëshimit të certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi duhet ti kthen autoritetit kontraktues të gjitha skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera të kontratës.

5.2 Përveç nëse është e nevojshme për qëllime të kontratës, skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera që i jep autoriteti kontraktues nuk duhet të përdoren as nuk duhet t'i komunikohen një pale të tretë nga Kontraktuesi pa pajtim paraprak të autoritetit kontraktues.

5.3 Autoriteti kontraktues ka autoritetin për t'i lëshuar Kontraktuesit urdhra administrative që inkorporojnë ato dokumente plotësuese dhe udhëzimet që janë të nevojshme për ekzekutim të mirë të kontratës dhe për kompensim dëmi nga ndonjë defekt të saj.

Neni 6 Qasja në vend punishte

6.1 Autoriteti kontraktues, në kohën e duhur dhe në përputhje me ecurinë e punimeve, do ti jap qasje dhe akses Kontraktuesit në vend punishte, në përputhje me programin e zbatimit të detyrave të përcaktuara në këto Kushte të përgjithshme.

6.2 Kontraktuesi, gjatë shfrytëzimit, duhet të mirëmbaje çdo objekt të vendosur në dispozicion të tij në gjendje të mirë, dhe duhet, nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktues, ti kthej ato në gjendjen e tyre origjinale pas përfundimit të kontratës.

6.3 Kontraktuesi nuk do të ketë të drejtë të ndonjë pagese për përmirësimet që rezultojnë nga puna e kryer me iniciativën e tij.

Neni 7 Ndihma lidhur me rregulloret vendore

7.1 Kontraktuesi mund të kërkojë ndihmën e Autoritetit kontraktues për marrjen e kopjeve të ligjeve, rregulloreve dhe informatave mbi zakonet, urdhëratë apo ligjet anësore të Republikës së Kosovës të cilat mund të ndikojnë te Kontraktuesi gjatë realizimit të obligimeve të tij me kontratë. Autoriteti kontraktues mund ta japë ndihmën e kërkuar Kontraktuesit me shpenzime të Kontraktuesit.

7.2 Në bazë të dispozitave të ligjeve dhe rregulloreve mbi punën, Autoriteti Kontraktues do të bëjë të gjitha përpjekjet e nevojshme për të lehtësuar prokurimin nga Kontraktuesi për të gjitha vizat dhe lejet e nevojshme, duke përfshirë lejen e punës dhe lejet e qëndrimit, për personelin, shërbimet e të cilëve Kontraktuesi dhe Autoriteti kontraktues i konsideron të nevojshme, si dhe lejet e qëndrimit për familjet e tyre.

OBLIGIMET E KONTRAKTUESIT

Neni 8 Obligimet e Kontraktuesit

8.1 Kontraktuesi duhet të veprojë sipas urdhrave administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Kontraktuesi konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrat. Ekzekutimi i urdhrat administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

8.2 Kontraktuesi duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

8.3 Kontraktuesi duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpalosë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

8.4 Nëse Kontraktuesi është grup, përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit kontraktues.

8.5 Kontraktuesi do të siguroj se punët do të fillojnë dhe të përfundojnë brenda afatit të caktuar rënë dakord në programin e bërë sipas Nenit 12.

8.6 Kontraktuesi do të siguroj që të gjitha punët që ai/ajo do të bëjë, si dhe riparimin e defekteve gjatë realizimit të punimeve do të bëhen në kohë dhe në përputhje me standardet, praktikat, metodat dhe procedurat ekzistuese dhe për më tepër me shkallën e aftësisë dhe zellit, e cila do të pritët nga një kontraktues i aftë dhe me përvojë që ka ndërmarr punë të ngjashme.

8.7 Kontraktuesi do të siguroj për cilësinë e punës dhe për cilësinë e materialeve dhe cilësisë profesionale të punonjësve që janë përdorur për realizimin e punëve të kontraktuara.

8.8 Kontraktuesi duhet të siguroj zonën e ndërtimit menjëherë pas fillimit të punës për arsyet e mëposhtme:

- a. në qoftë se për kryerjen e punëve pajisjet e rënda si: ekskavatorë të llojeve të ndryshme, vinça, kamionë të llojeve të ndryshme, skela të larta, etj do të përdoren dhe
- b. në mënyrë që të mos dëmtojë kalimtarët e rastit, objektet përreth, trafikun etj.

8.9 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në vend punim.

Neni 9 Personeli

9.1 Kontraktuesi duhet të punësoj personel kyç dhe të përdor pajisje të identifikuara në tender e tij, për të kryer punë ose personel tjetër dhe pajisje të aprovuara nga menaxheri i projektit. Menaxheri i Projektit do të aprovoj çdo zëvendësim të propozuar të personelit kyç dhe pajisjeve vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse, ose karakteristikat janë në thelb të barabarta ose më të mirë se ato të propozuara gjatë tenderit.

Neni 10 Siguria e ekzekutimit

10.1 Kontraktuesi do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mire të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Kontraktuesit.

10.2 Sigurimi do të vazhdoj të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të Certifikatës së Pranimit të Përkohshëm.

10.3 Siguria e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e dhënë në pjesën IV të kontratës.

Neni 11 Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit

11.1 Nga data e fillimit e deri sa të lëshohet Certifikata e Korrigjimit të Defekteve, rreziqet e lëndimeve personale, vdekja, dhe humbja ose dëmtimi i pronës (përfshirë, pa kufizim, Punët, Impiantet, Materiale, dhe Pajisjet) janë rreziqet e Kontraktuesit dhe pronës së afërt.

11.2 Kontraktuesi duhet të siguroj një sigurim nga dita fillimit të punimeve deri në fund të periudhës garantuese të defekteve në shumat e përcaktuara në KVK për ngjarjet e mëposhtme të cilat janë për shkak të rreziqeve të Kontraktuesit:

- (a) humbje ose dëmtim i Punëve, Impianteve dhe Materialeve;
- (b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve;
- (c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën; dhe
- (d) dëmtim ose vdekje e personelit të tij.

11.3 Kontraktuesi brenda 15 ditëve pas nënshkrimit të kontratës duhet t'i dërgojë Autoritetit Kontraktues policën dhe certifikatën për sigurim që ka për qëllim kompensimin e nevojshëm për të siguruar humbjen apo dëmet e pësuar.

11.4 Në qoftë se kontraktuesi nuk ofron një sigurim të tillë atëherë kontrata do të konsiderohet e anuluar dhe kontraktuesi do të përjashtohet nga pjesëmarrja në aktivitetet e prokurimit për jo më pak se një vit.

11.5 Në qoftë se ekzistojnë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për zgjatjen e afatit të ofrimit të certifikatës mbi sigurim, Autoriteti Kontraktues mund të zgjasë afatin e caktuar për dorëzimin e certifikatës mbi sigurimin ose të eliminojë sigurimin dhe të zbrisë çmimin e shpërblimit nga fitimi i kontraktuesit.

Neni 12 Programi

12.1 Brenda kohës së specifikuar në KVK, kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të Projektit një program për miratim. Programi do të përmbajë së paku me të vjetër: mënyrën se si Kontraktuesi propozon ekzekutimin e punëve, afatin kohor që kërkohet për dorëzim dhe miratim të vizatimeve, metodat e përgjithshme që do të zbatohen, dhe afatin kohor për secilin aktivitet të specifikuar.

12.2 Nëse menaxheri i projektit për më tepër kërkon modifikime në programin e punëve në kuadër të punëve të kontraktuara, kontraktuesi duhet ta rishikojë edhe njëherë programin dhe t'ia kthejë prapë Menaxherit të projektit. Kontraktuesi do të azhurnoj Programin në intervale jo më shumë se periudha e përcaktuar në KVK.

12.3 Për çdo pakënaqësi apo mosmarrëveshje në lidhje me modifikimin e programit, kontraktuesi do të sigurojë argument me shkrim Menaxherit të Projektit.

12.4 Paraqitja e programit të tillë, duke përfshirë çdo shtesë nga menaxheri i projektit nuk do të zvogëlojë ose të rrisë detyrimet e kontraktuesit sipas punëve të kontraktuara, si dhe çdo modifikim të përfshirë në programin e punimeve nuk do të rezultojë në ndonjë pagesë shtesë për kontraktuesin, nëse kjo ka ndodhur si pasojë e neglizhencës së kontraktuesit gjatë përpilimit të programit.

Neni 13 Siguria në vend punishte

13.1 Kontraktuesi do të ketë të drejtën të ndalojë qasjen në vend-punishte për çdo person i cili nuk është i përfshirë në zbatimin e kontratës, me përjashtim të personave të autorizuar nga Autoriteti Kontraktues.

13.2 Kontraktuesi do të sigurojë sigurinë në vend-punishte gjatë gjithë periudhës së ekzekutimit dhe do të jetë përgjegjës për të marrë hapat e nevojshëm, në interes të punonjësve të tij, agjentëve të Autoritetit Kontraktues dhe palëve të treta, për të parandaluar çdo humbje ose aksident i cili mund të rezultojë nga kryerja e punëve.

13.3 Kontraktuesi do të marrë të gjitha hapat e domosdoshme, për përgjegjësinë e tij dhe me shpenzimet e tij, për të siguruar që strukturat dhe instalimet ekzistuese mbrohen, ruhen dhe mirëmbahen. Ai do të jetë përgjegjës për sigurimin, me shpenzimet e tij, ndriçimin, sigurinë, skemën dhe pajisjet e sigurisë të cilat janë të nevojshme për zbatimin e duhur të detyrave ose që me arsye mund të kërkohen nga Autoriteti Kontraktues.

Neni 14 Ndërhyrja me trafikun

14.1 Kontraktuesi do të sigurojë që punimet dhe instalimet nuk shkaktojnë dëme, ose pengojnë trafikun në, lidhjet e komunikimit të tilla si rrugët, hekurudhat, rrugë ujore dhe aeroporte. Ai, në veçanti, do të marrë parasysh kufizimet në peshë kur zgjedh rrugët dhe automjetet.

14.2 Çdo masë te veçantë të cilën Kontraktuesi e konsideron të nevojshme, ose është kërkuar nga Autoriteti Kontraktues me qëllim të mbrojtjes apo për të përforcuar pjesët e rrugëve, urave, do të bartet në shpenzime të Kontraktuesit, pa marre parasysh se ato kryhen nuk ato kryhen nga Kontraktuesi. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin kontraktues për çfarëdo masa të veçanta që ai synon të ndërmarrë para se kryej ato. Riparimet e dëmit të shkaktuara në rrugë, ura nga transporti i materialeve apo pajisjeve do të jetë në shpenzime të Kontraktuesit.

Neni 15 Tatimi

15.1 Kontraktuesi është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

15.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

15.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të përfundimit të punëve.

15.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes së detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë kontraktuesi.

Neni 16 Kostoja e Riparimeve

16.1 Humbja ose dëmtimi i Punëve ose Materialeve që do të përfshihen në Punët në mes të Datës së fillimit dhe në fund të periudhës së Korrigjimit të Defekteve do të rregullohet nga Kontraktuesi në koston e Kontraktuesit nëse humbja ose dëmtimi lind nga aktet ose mosveprimet e Kontraktuesit.

FILLIMI DHE VONESAT

Neni 17 Fillimi i punëve

17.1 Kontraktuesi do të filloj punët brenda afatit kohor të specifikuar në KVK.

17.2 Kontraktuesi do të ndërtoj dhe instaloj Punët në pajtim me Specifikimet dhe Vizatimet dhe Punët do të kryhen në pajtim me Programin e dorëzuar nga Kontraktuesi, i përditësuar me miratimin e Menaxherit të Projektit, dhe do të plotësoj ato brenda afatit kohor të specifikuar në KVK.

Neni 18 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

18.1 Kontraktuesi mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsye:

- a) Autoriteti kontraktues ka dështuar t'i plotësojë obligimet e veta sipas kontratës;
- b) Forca madhore të përkufizuara si në Nenin 38;

18.2 Brenda 15 ditësh pasi ka kuptuar se mund të ketë vonesë, Kontraktuesi duhet ta lajmërojë Autoritetin Kontraktues se ka për qëllim të bëjë kërkesë për zgjatje të periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveç nëse ka ndonjë marrëveshje tjetër ndërmjet Kontraktuesit dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditësh i jep Autoritetit Kontraktues të dhëna gjithëpërfshirëse ashtu që të mund të kontrollohet kërkesa.

18.3 Brenda 30 ditësh pas pranimit të detajeve sipas Nenit 18.2 Autoriteti Kontraktues do të lejojë me shkrim Kontraktuesit këtë zgjatje të periudhës së realizimit nëse mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive ose retrospektive, ose ta informojë Kontraktuesin që nuk i është dhënë e drejta për zgjatje të periudhës.

Neni 19 Dëmet e likuiduara

19.1 Kontraktuesi do të paguaj dëmet e likuiduara Autoritetit Kontraktues në normën ditore të cekur në KVK për çdo ditë që Data e Përfundimit është me vonë se Data e Kërkuar e Përfundimit. Shuma totale e dëmeve të likuiduara nuk duhet të tejkaloj shumën e përcaktuar në KVK. Autoriteti Kontraktues mund të zbres dëmet e likuiduara nga pagesat për shkak të Kontraktuesit. Pagesa e dëmeve të likuiduara nuk do të ndikoj në detyrimet e Kontraktuesit.

19.2 Nëse Autoriteti Kontraktues ka fituar të drejtën e vlerës maksimale në bazë të nenit 19.1 ai mundet, pasi ta njoftojë Kontraktuesin:

- (a) konfiskojë garancinë e realizimit; dhe / ose
- (b) të ndërpresë kontratën; dhe
- (c) të hyjë në një kontratë me një palë të tretë në koston e Kontraktuesit për ofrimin e bilancit të punimeve.

MATERIALET DHE MJESHTËRITË

Neni 20 Regjistri i punës

20.1 Një regjistër i punës do të, përveç kur parashikohet ndryshe nga KVK, mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit, i cili do të mbaje të paktën informacionin e mëposhtëm:

kushtet e motit, ndërprerjet e punës që detyrohen nga moti me shi, orët e punës, numrin dhe llojin e punëtorëve të punësuar në vend-punishte, materialet e furnizuara, pajisjet në përdorim, pajisjet jo në gjendje pune, testet e kryera në vend, mostrat e dërguara, rrethanat e paparashikuara si dhe urdhrat dhënë Kontraktuesit;

deklaratat e hollësishme të të gjitha elementeve sasiore dhe cilësore të punës së bërë dhe furnizimet e dorëzuara dhe të përdorura, të afta për tu kontrolluar në vend-punishte dhe të rëndësishme në llogaritjen e pagesave që duhet bërë Kontraktuesit.

20.2 Shënimet e bëra në regjistrin e punës, si pune në progres, duhet të nënshkruhen nga Autoriteti Kontraktues dhe të bashkë-nënshkruhen nga Kontraktuesi ose përfaqësuesi i tij. Nëse Kontraktuesi refuzon, ai do të komunikojë pikëpamjet e tij ndaj Autoritetit Kontraktues në afat prej 15 ditësh pas datës në të cilën janë regjistruar të dhënat apo deklaratat kundërshtuese. Nëse Kontraktuesi dështon që të nënshkruajë ose të paraqesë pikëpamjet e tij brenda periudhës së lejuar, do të konsiderohet se Kontraktuesi pajtohet me shënimet e paraqitura në regjistër. Kontraktuesi mund të shqyrtojë regjistrin e punës në çdo kohë dhe mund, pa hequr dokumentin, të bëjë ose të marrë një kopje të shënimeve të cilat ai i konsideron të nevojshme për informacionin e tij.

20.3 Sipas kërkesës, Kontraktuesi do ta sigurojë Autoritetin Kontraktues me informacionin e duhur për të mbajtur regjistrin e punës në mënyrën e duhur.

Neni 21 Origjina dhe cilësia e punimeve dhe materialeve

21.1 Punët, komponentët dhe materialet do të jenë në përputhje me specifikimet, vizatimet, sondazhet, modellet, mostrat, strukturat dhe kërkesat tjera në kontratë dhe do të mbahen në dispozicion të Autoritetit kontraktues për qëllime identifikimi gjatë gjithë periudhës së realizimit.

21.2 Të gjitha pranimet teknike preliminare do të jenë objekt i një kërkesë të dërguar nga Kontraktuesi tek Autoriteti Kontraktues. Kërkesa duhet të referohet numrit të kontratës, numrin e Lotit dhe vendin ku do të zhvillohet pranimi i tillë, sipas rastit. Komponentët dhe materialet e specifikuar në kërkesë duhet të certifikohen nga autoriteti kontraktues se plotësojnë kërkesat për këtë pranim para se të inkorporohen në punë.

21.3 Edhe nëse janë pranuar teknikisht materialet apo artikujt që do të përfshihen në punë ose në prodhimin e komponentëve, ato mund të refuzohen dhe duhet të zëvendësohen menjëherë nga Kontraktuesi nëse ndonjë kontrollim tjetër zbulon defekte ose gabime. Kontraktuesit mund t'i jepet mundësia t'i riparojë dhe t'i përmirësojë materialet dhe artikujt që janë refuzuar, por këto materiale dhe artikuj do të pranohen për inkorporim në punë vetëm nëse janë riparuar.

Neni 22 Inspektimi dhe testimi

22.1 Autoriteti Kontraktues do të emërojë “Menaxherin e Projektit”, të cekur në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e ekzekutimit të punëve gjatë tërë kohës, duke filluar që nga dita e parë e fillimit të punëve e deri në skadimin e periudhës garantuëse të defekteve dhe për raportim tek Autoriteti Kontraktues.

22.2 Qëllimi i mbikëqyrjes është të kontrollojë cilësinë e punëve dhe cilësinë e materialeve të përdorura në pajtim me specifikimet teknike të rëna dakord.

22.3 Kontraktuesi do të sigurojë që komponentët dhe materialet të dorëzohen në kohë në vend për të lejuar autoritetit kontraktues që të vazhdojë me pranimin e komponentëve dhe materialeve. Kontraktuesi konsiderohet se ka vlerësuar plotësisht vështirësitë që mund t'i hasë në këtë aspekt, dhe nuk do të lejohet që të paraqesë ndonjë arsye për vonesë në përmbushjen e detyrave.

22.4 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë, ose nga vetë ose agjentit e tij, që të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë progresin e përgatitjes, fabrikimit apo

prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për ofrimin e sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar. Kjo do të bëhet në vendin e prodhimit, fabrikimit, përgatitjes ose në vend-punishte ose në ndonjë vend tjetër, siç mund të specifikohet në kontratë.

22.5 Nëse komponentët dhe materialet i kanë kaluar testet, Autoriteti kontraktues do ta njoftojë Kontraktuesin ose do të miratojë certifikimin e procedurës lidhur me këtë.

22.6 Nëse Autoriteti Kontraktues dhe Kontraktuesi nuk pajtohen për rezultatet e testit, secili do të japë një deklaratë për pikëpamjet e tij ndaj tjetrit brenda 15 ditëve pas ngritjes së mosmarrëveshjes së tillë. Autoriteti kontraktues ose Kontraktuesi mund të kërkojnë që këto teste të përsëriten në të njëjtat kushte dhe rrethana, ose nëse ndonjëra palë kërkon, nga një ekspert që zgjidhet me pëlqimin e përbashkët. Të gjitha raportet e testimit do t'i dorëzohen autoritetit kontraktues i cili do t'i komunikojë rezultatet e këtyre testeve pa vonesë të Kontraktuesit. Rezultatet e ri-testimit do të jenë përfundimtare. Kostoja e ri-testimit do të bartet nga pala pikëpamja e të cilit dëshmohet se është gabim nga ri-testimit.

Neni 23 Paralajmërim i hershëm

23.1 Kontraktuesi pa humbur kohë do të informojë Menaxherin e Projektit, në qoftë se vëren ndonjë gabim apo lëshim në skica (vizatime) apo edhe në specifikim gjatë kryerjes së punëve duke ia tërhequr vërejtjen se ato mund të ndikojnë me vone në kualitetin e punëve.

23.2 Nëse Menaxheri i Projektit vëren ekzistimin e disa gabimeve apo lëshimeve, qofshin ato në skica apo në specifikim teknik, ai/ajo do t'i evitojë menjëherë dhe do t'i konsideroj pasojat.

23.3 Nëse palët në kontratë vlerësojnë se ndërrimet substanciale të punëve janë bere të nevojshme për shkak të gabimeve të tilla ose të përjashtimeve të cilat substancialisht ndikojnë në çmimin e kontratës, atëherë Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me autoritetin kontraktues do të korrigojnë dhe kompensojnë situatën sipas Ligjit të Prokurimit Publik.

PAGESAT

Neni 24 Pagesa

24.1 Pagesat do të bëhen në Euro.

24.2 Pagesat do të rregullohen për zbritje për pagesat paradhënie dhe të mbajtjes. Autoriteti Kontraktues duhet të paguaj Kontraktuesit shumën e certifikuar nga Menaxheri i Projektit brenda 30 ditëve nga data e çdo certifikate. Nëse Autoriteti Kontraktues bën një pagesë me vonesë, Kontraktuesit do t'i paguhet interes për pagesë me vonesë në pagesën e ardhshme. Interesi do të llogaritet nga data në të cilën pagesa duhet të ishte bërë, deri në datën kur pagesa është bërë me vonesë, e rregulluar sipas bankave vendase për kredi në sektorin e ndërtimit.

24.3 Artikujt e Punëve për të cilat nuk është dhënë normë apo çmim nuk do të paguhet nga Autoriteti Kontraktues dhe do të konsiderohen të mbuluara nga normat dhe çmimet tjera në Kontratë.

24.4 Pagesat që duhet të bëhen sipas faturës së lëshuar nga Kontraktuesi do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, Identifikimi Financiar, i kësaj kontrate që e plotëson Kontraktuesi. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

Neni 25 Paramasa dhe Parallogaria

25.1 Paramasa dhe parallogaria duhet të përmbajnë pajisje për ndërtim, instalim, testim, dhe punën e komisioneve që duhet të kryhet nga ana e Kontraktuesit. Paramasa dhe parallogaria përdoret për të llogaritur çmimin e kontratës. Kontraktuesi do të paguhet për sasinë e punës së kryer në normën e Paramasës dhe Parallogarisë për çdo artikull.

25.2 Në rast të kontratës paushallë, Përshkrimi i Aktivitetit duhet të përmbajë aktivitetet me çmim për punët e kryera nga ana e Kontraktuesit. Përshkrimi i Aktivitetit përdoret për monitorim dhe kontroll të kryerjes së aktiviteteve në bazë të të cilave Kontraktuesi do të paguhet. Nëse pagesa për Materiale në vend punim do të bëhet veç e veç, Kontraktuesi do të tregojë shpërndarjen e Materialeve në vend punim veçmas në Përshkrimin e Aktivitetit.

Neni 26 Parapagimi

26.1 Autoriteti Kontraktues do të bëjë pagesë paradhënie Kontraktuesit të shumave të përcaktuara në KVK nga data e caktuar në KVK kundër dispozitës nga Kontraktuesi i një Garancioni të Pakushtëzuar Bankar në një formë të

pranueshme për Autoritetin Kontraktues në sasi dhe valutë të barabartë me parapagim. Garancia do të mbetet në fuqi deri sa të bëhet pagesa e parë, por shuma e garancisë duhet të reduktohet në mënyrë progresive nga shuma që paguhet nga Kontraktuesi. Interesi nuk do të paguhet për parapagim.

26.2 Kontraktuesi do të përdorin parapagimin vetëm për të paguar Pajisjet, materialet dhe shpenzimet e tjera të nevojshme posaçërisht për kryerjen e punëve. Kontraktuesi duhet të dëshmojë se pagesa paradhënie është përdorur në këtë mënyrë me furnizim të kopjeve të faturave ose dokumenteve të tjera për Menaxherin e Projektit.

26.3 Parapagim do të paguhet duke zbritur shuma proporcionale nga pagesat përndryshe për shkak të Kontraktuesit, pas orarit të përqindjeve të përfunduar të Punëve në bazë të pagesës.

Neni 27 Mbajtja e Parasë

27.1 Shuma, e specifikuar në KVK, do të ndalet nga çdo pagesë e Kontraktuesit deri në përfundim të tërë të Punëve. Kjo shume në asnjë rast nuk do të tejkalojë 10% e vlerës totale të kontratës origjinale. Kontraktuesi mund të zëvendësojë paratë e mbajtura me garancion bankar “me kërkesë”.

27.2 Shuma e mbajtur ose garancia e mbajtjes do të paguhet brenda 30 ditësh nga dita e lëshimit të deklaratës së llogarisë përfundimtare të referuar në Nenin 29.

Neni 28 Vërtetimet e pagesës

28.1 Kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të projektit raportet mujore të çmimeve të vlerësuara të punëve të përfunduara me minus shumën kumulative të vërtetuar më parë.

28.2 Menaxheri i Projektit do ta kontrollojë punën e kryer të kontraktuesit për të vërtetuar cilësinë e punës dhe vërteton shumën që duhet t'i paguhet kontraktuesit.

28.3 Vlera e punës së kryer do të përcaktohet nga Menaxheri i Projektit.

28.4 Vlera e punës së përfunduar përfshin:

- a) Në rastin e Kontratës së Paramasës dhe Parallogarisë, vlerën e sasisë së punës në Paramasë dhe Parallogari që është përfunduar; ose
- b) Në rast të kontratës paushallë, vlera e punës së ekzekutuar do të përbëjë vlerën e aktiviteteve të përfunduara në Përshkrimin e Aktivitetit.

28.5 Vlera e punës së përfunduar përfshin vlerësimin e ndryshimeve dhe shkaqeve për kompensim.

Neni 29 Llogaritja përfundimtare

29.1 Kontraktuesi jo më vonë se 90 ditë pas lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit, do të dorëzojë tek Menaxheri i Projektit një draft të deklaratës së llogarisë përfundimtare me dokumentet mbështetëse që tregojnë në detaje vlerën e punës së bërë në përputhje me kontratën, së bashku me të gjitha shumat e mëtejshme të cilën Kontraktuesi konsideron se duhet paguar sipas kontratës, në mënyrë që Menaxheri i Projektit të përgatis deklaratën e llogarisë përfundimtare.

29.2 Brenda 30 ditëve pas pranimit të draft-deklaratës së llogarisë përfundimtare dhe të gjithë informacionit të kërkuar në mënyrë të arsyeshme për verifikimin e saj, Menaxheri i Projektit do të përgatisë deklaratën e llogarisë përfundimtare, e cila përcakton:

- a) Shumen e cila sipas opinionit të tij duhet të paguhet sipas kontratës; dhe
- b) pas evidentimit të shumave të paguara paraprakisht nga Autoriteti Kontraktues dhe i të gjitha shumave të cilat i takojnë Autoritetit Kontraktues sipas kontratës, bilanci, nëse ka, nga Autoriteti Kontraktues tek Kontraktuesi, ose nga Kontraktuesi tek Autoriteti Kontraktues, siç mund të jete rasti.

29.3 Menaxheri i Projektit do të lëshojë te autoriteti kontraktues ose te përfaqësuesi i tij i autorizuar, dhe te Kontraktuesi, deklaratën e llogarisë përfundimtare që paraqet shumën përfundimtare për të cilën duhet paguar Kontraktuesi në bazë të kontratës. Autoriteti kontraktues ose përfaqësuesi i tij i autorizuar dhe Kontraktuesi duhet të nënshkruajnë deklaratën e llogarisë përfundimtare, si një njohje e vlerës së plotë dhe përfundimtar të punës së realizuar sipas kontratës dhe menjëherë do të dorëzojë një kopje të nënshkruar të Menaxherin e Projektit.

Neni 30 Shkaqet për kompensim

30.1 Shkaqe për kompensim konsiderohen ngjarjet si në vijim:

- (a) Autoriteti Kontraktues nuk lejon qasje në një pjesë të vend ndërtimit data e posedimit e specifikuar në KVK.
- (b) Menaxheri i Projektit urdhëron shtyrje pa dhënë llogari për këtë, ose vonohet apo nuk i jep skicat (vizatimet, specifikacionet) apo udhëzimet e duhura për kryerjen e punëve të kontraktuara në afatin e caktuar si në kontratë.
- (c) Menaxheri i Projektit urdhëron kontraktuesin që t'i zbulojë ose kryejë testet në punën përfundimtare, e cila mandej zbulohet se nuk ka pasur defekt.
- (d) Kontraktuesit tjerë, autoritetet publike, shërbimet komunale ose Autoriteti Kontraktues shkaktojnë vonesë apo shpenzime shtesë për Kontraktuesin.
- (e) Parapagimi vonohet.
- (f) Menaxheri i Projektit pa arsye të justifikuar vonohet në lëshimin e vërtetimit për përmbushje të kontratës.
- (g) Kontraktuesi has në pengesa për kryerjen e aktiviteteve të punëve të kontraktuara të cilat pengesa nuk janë për shkak të joprofesionalizmit të Kontraktuesit.

30.2 Nëse një ngjarje e tillë ndodh, atëherë Çmimi i Kontratës do të rregullohet po ashtu.

PRANIMI DHE PËRGJEGJËSIA MBI DEFEKTET

Neni 31 Parimet e përgjithshme

31.1 Verifikimi i punëve nga Autoriteti Kontraktues me qëllim të pranimit të përkohshëm ose final do të bëhet në prani të Kontraktuesit. Mungesa e kontraktuesit nuk do të jetë pengesë për verifikimin me kusht që Kontraktuesi të jete informuar prej të paktën 30 ditëve para datës së verifikimit.

Neni 32 Testet për përfundimin

32.1 Punët nuk do të pranohen deri sa të jene kryer verifikimet dhe testet e caktuara në shpenzime të Kontraktuesit. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktues për datën në të cilën verifikimi dhe testet të tilla mund të fillojnë.

32.2 Punët të cilat nuk plotësojnë kushtet e kontratës, duhet, nëse kërkohet, të shkatërrohen dhe rindërtohen nga kontraktuesi ose të riparohen, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues, përndryshe kjo do të bëhet pas njoftimit të duhur në shpenzime të Kontraktuesit, me urdhër të Autoritetit Kontraktues.

Neni 33 Pranimi i përkohshëm

33.1 Punimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet për pranim dhe të jete lëshuar, ose konsiderohet të jete lëshuar, një certifikatë e pranimit të përkohshëm.

33.2 Kontraktuesi mund të aplikojë, duke njoftuar Autoritetin Kontraktues, për një certifikatë të pranimit të përkohshëm jo më herët se 15 ditë para se punët, sipas mendimit të Kontraktuesit, të jene të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të aplikacionit të Kontraktuesit ose:

- a) t'i lëshojë kontraktuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar punët në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose
- b) të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij i kërkon nga Kontraktuesi për ta lëshuar certifikatën.

33.3 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej 30 ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe.

33.4 Pas pranimit të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkitazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkohen në kontratë.

Neni 34 Përgjegjësia mbi Defektet

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë të punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës së defekteve dhe të cilat lindin nga ose:

- a) përdorimin i impiantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshtëria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit; dhe / ose
- b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës së defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do të fillojë nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdohet vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërrimi apo rinovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojnë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjojë një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë punë, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto të Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranimin të përkohshëm.

Neni 35 Pranimi përfundimtar

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një certifikatë të pranimin përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimin do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimin nga Menaxheri i Projektet dhe të jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimin dhe të cilat kanë mbetur të përealizuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimin. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

SHKELJA E KONTRATËS DHE SHKËPUTJA

Neni 36 Shkelja e kontratës

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhet Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

Neni 37 Shkëputja e kontratës

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonësës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundojë vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më pare që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të siguroj vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 38 Forca madhore

38.1 "Force Madhore" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplodimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësisë të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 39

Pagesa pas shkëputjes së kontratës

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshojë një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 40

Prona

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41

Lirimi nga Ekzekutimi

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbyshja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetojë këtë. Kontraktuesi do të sigurojë vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Neni 42

Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.


PJESA III E KONTRATES KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha Shqipe .
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shuma e sigurisë së ekzekutimit është 10 % me vlefshmëri prej 105 diteve per LOT 1 .
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: N/A
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda 15 ditë kalendarike nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periodha për Programin e azhurnuar është 15 ditë kalendarike nga data e pranimit të kërkesës së Menaxherit të projektit .
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë 15 ditë pas nënshkrimit të kontratës .
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë 75 LOT 1 ditë kalendarike.
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25% e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë . Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e Çmimit final të Kontratës.
Regjistri i punës	20.1	Një regjistër i punës do të mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit,
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit është: do të përcaktohet pas nënshkrimit të kontratës
Parimet e përgjithshme të pagesave	24	Lot 1 Autoriteti Kontraktues do ti paguaj kontraktuesit vlerën e kontraktuar në situacione . Pagesa e fundit –nuk mund të jetë më e vogël se 10% e çmimit të kontraktuar, bazuar në konstatimin e menaxherit dhe mbikqyresit të kontratës.
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: nuk ka pagese paraprake
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: 10% i vlerës së kontratës . Kjo shume do të ndalet nga çdo pagesë e Kontraktuesit dhe do të paguhet brenda 30 ditësh nga dita e lëshimit të deklaratës së Ilogarisë përfundimtare të referuar në Nenin 29 të KPK.

		bankar "me kërkesë". Shuma e parave të mbajtura do të mbahet gjatë tërë periudhës së defekteve (5 vite)
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë 15 ditë kalendarike pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuese e defekteve është 5 vite
Pagesa shkëputjes kontratës pas së	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve të likuiduara.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Komisioni për Ndërmjetësim në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Themelore-Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë.ose b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë. Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.


Renovimi i Qendrës Kryesore për të Shurdhërit					
PARAMASA DHE PARALLOGARIA					
Nr.	Përshkrimi:	Njësia	Sasia	Çmimi (€)	Shuma (€)
Masat e sigurisë: Duhet të jenë në nivelin më të lartë për arsye të ruajtjes së shëndetit të personave që punojnë dhe jetojnë afër punishtes. Pra në këtë mënyrë duhet të bëhet sigurimi i punishtes dhe vendosjes së materialeve në të si dhe të merren masat e nevojshme të sigurisë (preventiva) hapësinore në mes të zonës nën ndërtim dhe zonave të tjera të cilat mbeten në shfrytëzim gjatë fazës së punimeve. Vërejtje: Çmimi për çdo pozicion duhet të përfshijë: Furnizimin, transportin, punimin, montimin, lidhjet, sjelljen e pozicionit në gjendje plotësisht funksionale, garancinë, testimet si dhe kompletimin e certifikatave dhe testeve të prodhueseve. Në çmim duhet të kalkulohet gjithashtu i tërë materiali shpenzues deri në kompletim të tij. Dimensionet për realizim gjithmonë të merren në vend. Produktet e propozuara të gjitha duhet përcillen me certifikatë të kualitetit të prodhuesit. Duhet të përmbushin ISO standardet. Vërejtje: Të bëhen verifikimet dhe matjet e hapësirës. Për ngjyra dhe tekstura të konsultohet paraprakisht organi mbikëqyrës.					
1	PUNËT E DEMOLIMIT NË OBJEKT				
1.1	Demolimi i mureve ekzistuese me trashësi të ndryshme nga tullat, plakat e gipsit dhe materialeve të tjera. Pozicioni përfshinë demolimin e mureve dhe instalimeve elektrike apo hidroinstalimeve që mund të jenë nëpër mure, si dhe bartja e tyre deri në deponinë e caktuar nga organet komunale, jo më pak se 5km.	m ²	50	€ 2.00	€ 100.00
1.2	Demolimi, pastrimi i dyshemesë ekzistuese, për përgatitjen e shtresave të reja të objektit. Në pozicion të përfshihen të gjitha shtresat e dyshemeve deri në nivel të pllakës së meskatit dhe largimi i saj deri në deponinë e caktuar nga organet komunale. Të gjitha dyshemetë që do të demoloohen të llogariten me të gjitha shtresat (parket, qeramikë, estrih, termoizolim, hidroizolim, masë rrafshuese etj.) deri në pllakën e meskatit duke përfshirë edhe gypat e ujit dhe kanalizimit dhe instalimeve tjera nëse ka si dhe pastrimi me presion me ajër. Të përgatitet hapësira për vendosjen e dyshemesë së re. Në pozicion të parashihet edhe transporti deri në deponinë e caktuar nga organet komunale.	m ²	350	€ 0.50	€ 175.00
1.3	Gryerja e sipërfaqes së ngjyrës, gletit, suvatimit në muret, në hapësirat ku është e nevojshme, si dhe tavanet e brendshme të hapësirave që duhet renovuar. Pastrimi, gryerja deri në tulla të bëhet në hapësirat ku është e nevojshme. Duhet të jetë e gatshme për vendosjen e suvatimit të ri sipas nevojës. Sipas nevojës duhet të bëhet gërryerja përgjatë perimetrit të dritareve në mënyrë që të ketë hapësirë të mjaftueshme për montimin e dritareve të reja. Pozicioni përfshinë edhe pastrimin e punishtes gjatë gjithë kohës së realizimit të këtij aktiviteti si dhe largimi i mbeturinave deri në deponinë e caktuar nga organet komunale.	m ²	950	€ 0.10	€ 95.00
1.4	Demolimi i pllakave të qeramikës në mure. Duhet të jetë e gatshme për vendosjen e pllakave të reja pastrimi gryerja deri në tulla të bëhet në hapësirat ku është e nevojshme. Pozicioni përfshinë pastrimin e punishtes gjatë gjithë kohës së realizimit të këtij aktiviteti si dhe largimi i mbeturinave deri në deponinë e caktuar nga organet komunale.	m ²	30	€ 2.00	€ 60.00
1.5	Demolimi i elementeve të banjove, në pozicion përfshihet heqja e të gjitha elementeve të cilat gjenden në hapësirat e banjove. Largimi dhe deponimi i këtyre elementeve të cilat janë në gjendje të mirë të përcaktohet nga personi zyrtar, ndërsa elementet e panevojshme të dërgohen në deponi jo më afër se 5km.	Copë	7	€ 5.00	€ 35.00
1.6	Demolimi i dritareve, duke përfshirë transportin deri në deponinë e caktuar nga organi mbikëqyrës i komunës.	Copë	25	€ 2.00	€ 50.00



				Nëntotali 1	€ 533.00
2	PUNËT E MUREVE				
	Vërejtje: Në çmim për vendosjen e pllakave të gipsit duhet të parashihen të gjitha elementet dhe pajisjet për funksionalizimin e murit si: profila metalik horizontal dhe vertikal, bulonat shtangues, pllakat e gipsit, etj.				
2.2	Furnizimi me material dhe punimi i mureve të kuzhinës dhe zyres me trashësi 10 cm nga pllakat e gipsit me profile metalike. Plakat duhet të vendosen në të dy anët e profilave. Duhet të shtangohen në mënyrë adekuate sipas standardeve në fuqi. Në pozicion duhet të përfshihen të gjitha materialet tjera përcjellese për funksionalizimin e tij pozicioni (profilat metalik, bulonat, mbajtëset etj.) si dhe hapjet e derve sipas projektit. gjithashtu në këtë pozicion përfshihet edhe masa rrafshuese, rrjeta, ngjitësi, gletë dhe ngjyra.	m²	35.0	€ 35.00	€ 1,225.00
				Nëntotali 2	€ 1,225.00

3	PUNËT E SUVATIMIT				
Sipërfaqja është e kalkuluar bruto përfshirë shpaletat, këndoret e nevojshme nga prodhuesi, fugat e dilatimit për fasadë, këndoret me ngjitës nga PVC-ja rreth dritareve - hapjeve. Hapjet zbriten nëse janë më të mëdha se 2m² (vetëm hapjet deri në 2m² llogariten në sipërfaqe bruto). Në këtë pozicion përfshihen edhe të gjitha materialet dhe punët përcjellese të nevojshme për realizimin e aktiviteteve. Të gjitha pozicionet përfshijnë edhe materialin lidhës, skelet si dhe pastrimin e vendit pas realizimit të kësaj aktiviteti.					
3.1	Furnizimi me material dhe punimi i masës rrafshuese dhe gletit në muret e brendshme të objektit. Në pozicion përfshihet gjithashtu rrjeta sipas nevojës dhe të gjitha mjetet e nevojshme për funksionalizimin dhe finalizimin e kësaj pozicioni.	m²	800	€ 1.50	€ 1,200.00
3.2	Furnizimi me material dhe riparimi i kulmit në sipërfaqe të caktuara të kulmit ku është e dëmtuar. Informatë: Kulmi është me mbulesë (crepë) harkore model i vjetër, drresa, listela. Duhet të hiqen të dëmtuarat dhe të rivendosen të reja. Pra intervenohet në vende ku ka dëmtime kulmi i objektit. Çmimi i riparimit të kulmit duhet të jepet në m².	m²	20	€ 35.00	€ 700.00
3.3	Furnizimi me material dhe punimi i pllakave të gipsit me profile metalike në plafone. Duhet të shtangohen në mënyrë adekuate sipas standardeve në fuqi, në trajet e druri të konstruksionit meskat. Në pozicion duhet të përfshihet grryrja e suvas në plafone për fiksimin e konstruksionit në traun e drurit, gjitha materialet tjera përcjellese për funksionalizimin e tij (profilat metalik, bulonat, mbajtëset etj.) gjithashtu në këtë pozicion përfshihet edhe masa rrafshuese, rrjeta, ngjitësi, gletë dhe ngjyra me tri shtresa ngjyre dispezeve e kualitetit të lartë, lehte i aplikueshem, difuz në ujë dhe në ajër, e qëndrueshem në ferkim dhe pastrim me leckë, e përshatshem për nuancim pa materie që avullohen.	m²	400	€ 17.00	€ 6,800.00
3.4	Furnizimi me material dhe punimi i suvasë në muret e brendshme të objektit. Në pozicion përfshihen: beton kontakt në sipërfaqet e nevojshme, spërkatja me ilaç të vrazhdë suvaje, ilaç suvatimi. Në pozicion përfshihet gjithashtu rrjeta, këndoret dhe të gjitha mjetet e nevojshme për funksionalizimin dhe finalizimin e suvatimit.	m²	800	€ 1.20	€ 960.00
				Nëntotali 3	€ 8,960.00


4	PUNËT E DYSHEMESË				
4.1	Furnizimi me material dhe montimi i hidroizolimit të ftoft dy komponentsh në dyshemënë dhe muret e nyjeve sanitare, me ngjitje në mure në lartësi minimale 100cm, kjo përfshinë edhe tharjen e dyshemesë.	m²	80	€ 2.00	€ 160.00



4.2	Furnizimi me material si dhe punimi i shtresës së dyshemesë me styropor d=30mm + d=20mm - N4. Në pozicion të përfshihet edhe shiriti ndarës në mes murit dhe dyshemesë.	m ²	370	€ 1.60	€ 592.00
4.3	Furnizimi me material dhe shtruarja e estrih betonit me trashësi min.5cm, dhe PVC folie. (Vërejtje: estrih betonit duhet të mbërrijë fortësinë e nevojshme). Lagështia e estrihut para shtrirjes së dyshemesë duhet të jetë < 4%.	m ²	370	€ 4.90	€ 1,813.00
4.4	Furnizimi me material dhe montimi i laminatit me trashësi 10mm AC4. Në pozicion përfshihet termofolla, llajset 6cm me ngjyre të bardhe.	m ²	220	€ 14.00	€ 3,080.00
4.5	Furnizimi dhe instalimi i pllakave të dyshemesë nga porcelani i klasës së parë, dy herë të pjekura, sipas EN 14411 :2004(ISO 13006), Fortësia min.50N/mm ² sipas UNI EN ISO 10545 - 4. Rezistenca ndaj abrazionit të përmbushë kushtet sipas UNI EN ISO 10545-6. Rezistenca ndaj ngricave duhet të takoj grupit Bla Klasa (UGL) sipas UNI EN 14411, Absorbimi i ujit duhet të jetë më e ulët se 0.5%. Rezistenca ndaj acideve dhe bazave sipas NI EN ISO 10545-13. Vendosja e pllakave duhet të bëhet konform Standardit EN 13888. Në çmim duhet të përfshihen edhe këndoret e aluminit, ngjytës, fuga dhe të gjitha punë tjera të nevojshme për të arritur produktin final. Dimensionit ~ 60x60cm dhe ngjyra përcaktohen nga organi mbikqyrës. Në pozicion të përfshihen edhe cokllat nga i njëjti material i pllakave si të dyshemesë, në lartësi prej 5cm.	m ²	130	€ 19.00	€ 2,470.00
4.6	Furnizimi dhe instalimi i pllakave të murit nga porcelani i klasës së parë, dy herë të pjekura, sipas EN 14411 :2004(ISO 13006), Fortësia min.50N/mm ² sipas UNI EN ISO 10545 - 4. Rezistenca ndaj abrazionit të përmbushë kushtet sipas UNI EN ISO 10545-6. Rezistenca ndaj ngricave duhet të takoj grupit Bla Klasa (UGL) sipas UNI EN 14411, Absorbimi i ujit duhet të jetë më e ulët se 0.5%. Rezistenca ndaj acideve dhe bazave sipas NI EN ISO 10545-13. Vendosja e pllakave duhet të bëhet konform Standardit EN 13888. Në çmim duhet të përfshihen edhe këndoret e aluminit, ngjytës, fuga dhe të gjitha punë tjera të nevojshme për të arritur produktin final. Dimensionit ~60x60 dhe ngjyra përcaktohen nga organi mbikqyrës.	m ²	30	€ 19.00	€ 570.00
Nëntotali 4				€ 8,685.00	

5 PUNËT E ZDRUKHTARISË					
Në pozicion të parashihet edhe furnizimi me material dhe vendosja e dyerve dhe dritareve të reja. Pozicioni përfshinë të gjitha materialet dhe punimet e nevojshme që ky aktivitet të jetë funksional. Vërejtje: Të gjitha matjet e dyerve dhe dritareve duhet të bëhen në vend nga punëkryesi para se të prodhohen.					
5.1	Riparimi i derës së hyrjes në përdheshë me dimensione të përafërta 320cm x 250cm. Materiali i derës ekzistuese është metal dhe xham. Në pozicion duhet të përfshihet gërryerja e ngjyrës ekzistuese për eliminimin e ndryshkut eventual, demontimi i pjesve dhe fletzave metalike të demtuara dhe zëvendëzimi i tyre me të reja, largimi i xhamave të dëmtuar, ngjyrosja me ngjyrën bazë mbrojtëse kundër ndryshkut si dhe ngjyrosja me ngjyrë finale antracit mat. Sipërfaqe metalike ka ~4m ² kurse sipërfaqe me xham ~4m ² . Xhami i dëmtuar duhet të zëvendësohet me xham të armuar.	Copë	1	€ 150.00	€ 150.00

5.2	Riparimi i derës së hyrjes në përdhesë me dimensione të përafërta 320cm x 280cm. Materiali i derës ekzistuese është metal dhe xham. Në pozicion duhet të përfshihet gërryerja e ngjyrës ekzistuese për eliminimin e ndryshkut eventual, demontimi i pjesve dhe fletzave metalike të demtuara dhe zvendëzimi i tyre me të reja, largimi i xhamave të dëmtuar, ngjyrosja me ngjyrën bazë mbrojtëse kundër ndryshkut si dhe ngjyrosja me ngjyrën finale antracit mat. Sipërfaqe metalike ka ~4m ² kurse sipërfaqe me xham ~4m ² . Xhami i dëmtuar duhet të zëvendësohet me xham të armuar.	Copë	1	€ 150.00	€ 150.00
5.3	Furnizimi transporti dhe montimi i dritareve me dimensione të përafërta 160cm x 180cm. Profilet PVC t=8cm, xham 3 shtresor loë-e. Dritaret duhet të kenë mundësinë e hapjes në 2 krah dhe pjesën e sipërme statike. Në pozicion përfshihen të gjitha elementet e nevojshme për funksionalizimin e tyre.	Copë	19	€ 240.00	€ 4,560.00
5.4	Furnizimi transporti dhe montimi i dritares me dimensione të përafërta 180cm x 260cm. Profilet PVC t=8cm, xham 3 shtresor loë-e. Dritaret duhet të kenë mundësinë e hapjes në 2 krah dhe pjesën e poshtme statike. Në pozicion përfshihen të gjitha elementet e nevojshme për funksionalizimin e tyre.	Copë	1	€ 380.00	€ 380.00
5.5	Furnizimi transporti dhe montimi i dritares fikse me dimensione të përafërta 160cm x 180cm. Profilet PVC t=8cm, xham 3 shtresor loë-e. Dritaret duhet të kenë mundësinë e hapjes në 2 krah. Në pozicion përfshihen të gjitha elementet e nevojshme për funksionalizimin e tyre.	Copë	1	€ 290.00	€ 290.00
5.6	Furnizimi transporti dhe montimi i dritareve me dimensione të përafërta 160cm x 60cm. Profilet PVC t=8cm, xham 3 shtresor loë-e. Dritaret duhet të kenë mundësinë e hapjes në 2 krah. Në pozicion përfshihen të gjitha elementet e nevojshme për funksionalizimin e tyre.	Copë	6	€ 145.00	€ 870.00
5.7	Furnizimi, transporti dhe montimi i dyerve të brendshme të xhamit pa kornizë 12mm. Dizajni i xhamit të jetë i kombinuar transparent me të akullit. Në çmim të përfshihet edhe furnizimi dhe montimi i kornizës MDF (të merret parasysh trashësia e murit për kornizë ~30cm) për derë me dimensione të përafërta 90cm x 210cm. Në pozicion përfshihen të gjitha elementet e nevojshme për funksionalizim.	Copë	7	€ 340.00	€ 2,380.00
5.9	Riparimi i derës së hyrjes në përdhesë me dimensione të përafërta 160cm x 250cm. Materiali i derës ekzistuese është metal dhe xham. Në pozicion duhet të përfshihet gërryerja e ngjyrës ekzistuese për eliminimin e ndryshkut eventual, demontimi i pjesve dhe fletzave metalike të demtuara dhe zvendëzimi i tyre me të reja largimi i xhamave të dëmtuar, ngjyrosja me ngjyrën bazë mbrojtëse kundër ndryshkut si dhe ngjyrosja me ngjyrën finale antracit mat. Sipërfaqe metalike ka ~4m ² kurse sipërfaqe me xham ~4m ² . Xhami i dëmtuar duhet të zëvendësohet me xham të armuar.	Copë	1	€ 150.00	€ 150.00
	Riparimi i gardhit ekzistues të shkallëve me gjatësi ~15m dhe lartësi h=90cm. Në pozicion duhet të përfshihet gërryerja e ngjyrës ekzistuese për eliminimin e ndryshkut eventual, ngjyrosja me ngjyrën bazë mbrojtëse kundër ndryshkut si dhe ngjyrosja me ngjyrën finale antracit mat. Strugimi i dorzës ekzistuese prej drurit, dhe finalizimi me llak pa ngjyre.	m'	15	€ 5.00	€ 75.00
5.10	Furnizimi transporti dhe montimi i pikoreve të dritareve në anën e jashtme. Materiali Alumin. Në pozicion përfshihet ngjitësi adekuat për përdorim të jashtëm dhe rezistent ndaj kushteve atmosferike, bulonat si dhe anësoret e pikoreve. Ngjyra përcaktohet nga	m'	34	€ 15.00	€ 510.00



6 PUNËT E NGJYROSJES					
Sipërfaqja është e kalkuluar bruto. Hapjet zbriten nëse janë më të mëdha se 2m ² (vetëm hapjet deri në 2m ² llogariten në sipërfaqe bruto). Në këtë pozicion përfshihen edhe të gjitha materialet dhe punët përcjellëse të nevojshme për realizimin e aktiviteteve.					
6.1	Furnizimi me material dhe ngjyrosja e mureve me tri shtresa ngjyrë dispezeve e kualitetit të lartë, lehtë të aplikueshem, difuz në ujë dhe në ajër, e qëndrueshem në ferkim dhe pastrim me leckë, e përshtatshme për nuancim pa materie që avullohen.	m ²	800.0	€ 2.50	€ 2,000.00
Nëntotali 6					€ 2,000.00

7 RRJETI I UJESJELLESIT					
Furnizimi, transporti dhe montimi i tubave fleksibil të ujesjellesit nga materiali PE-X (polyphenylene sulphone). gypat duhet të jenë nga plastika, tipi GIACOMINI (ose të ngjajshëm) të futura në dyscheme dhe mur. Në çmim të llogariten të gjitha pjesët fazonike					
7.1	Identifikimi dhe kyçja në rrjetin kryesor të ujesjellesit ekzistues, brenda në objektin tek nyja sanitare. Në çmim të llogariten furnizimi dhe montimi i pjesëve fazonike të nevojshme për funksionalizimin të rrjetit të ujesjellesit.	Paushall	1	€ 20.00	€ 20.00
7.2	Furnizimi dhe montimi i gypave dhe pjesëve fazonike të duhura të ujesjellesit. Gypat duhen të jenë nga plastika, të tipave të kualitetit të lartë, të futura në dyscheme dhe mur. Në çmim duhet të parashihet gypat për mbrojtje "zorra" dhe elementet tjera për lidhje me dyshemën dhe murin.				
7.2.1	Ø25mm, 1"	m'	1	€ 6.00	€ 6.00
7.2.2	Ø20mm, 3/4"	m'	3	€ 4.00	€ 12.00
7.2.3	Uji i ftohtë Ø16mm, 1/2"	m'	35	€ 1.00	€ 35.00
7.2.4	Uji i nxehtë Ø16mm, 1/2"	m'	17	€ 2.00	€ 34.00
7.3	Furnizimi dhe montimi i kutisë shpërndarëse 60x50cm, në murin e banjës, me material plastike për të izoluar kolektorin nga muri por dhe si pike kontrolli për monitorim ose ndërhyrje, në nyjën e rrjetit të ujesjellesit për ujë të ngrohtë dhe për ujë të ftohtë. Në të montohen të gjitha pjesët e nevojshme fazonike duke përfshirë valvulat, holanderat, rregullatorët e presionit, niplat dhe aksesore të tjerë të cilat shërbejnë për montimin e kutijes shpërndarëse	Copë	1	€ 15.00	€ 15.00
7.4	Furnizimi dhe montimi i lidhjeve-kolektorëve në kutinë shpërndarëse, kolektori për ujë të ftohtë ka 8 hyrje (qarkullim i ujit të ftohtë), kolektori për ujë të nxehtë ka 5 hyrje (qarkullim i ujit të nxehtë).	Komplet	1	€ 120.00	€ 120.00
7.5	Furnizimi dhe montimi i EK- valvulë (ventilave), me diametër Ø16mm, 1/2" së bashku me pjesët e nevojshme për të e kompletuar.	Copë	14	€ 5.00	€ 70.00
7.6	Furnizimi dhe montimi i valvulave (ventilave), me diametër Ø20mm, 3/4" së bashku me pjesët e nevojshme për të e kompletuar.	Copë	2	€ 13.00	€ 26.00
7.7	Shqyrtimi i gjithë rrjetit të ujesjellesit.	Komplet	1	€ 5.00	€ 5.00
Nëntotali 7					€ 343.00

8 RRJETI I KANALIZIMIT					
------------------------	--	--	--	--	--

8.1	Furnizimi dhe montimi i gypave PVC të kanalizimit dhe pjesëve fazonike me gjithë materialin e nevojshëm. (kthesat, T-pjesët, rekuduesit, revizionet etj). Në çmim të llogaritet të gjitha elementet për shtangim të gypave sipas rekomandimeve të prodhuesit dhe termoizolimet në vendet e caktuara.				
8.1.1	Ø50mm	m'	5	€ 2.00	€ 10.00
8.1.2	Ø75mm	m'	4	€ 3.00	€ 12.00
8.1.3	Ø110mm	m'	4	€ 4.00	€ 16.00
8.2	Furnizimi dhe montimi i ujëmbledhësit nga plastika Ø75mm dhe me kapak nga inox-i i montuar në dyshe.	Copë	1	€ 15.00	€ 15.00
8.3	Shqyrtimi i gjithë rrjetit të kanalizimit.	Komplet	1	€ 5.00	€ 5.00
				Nëntotali 8	€ 58.00

9	ELEMENTET SANITARE				
9.1	Furnizimi, transporti dhe montimi i komplet i lavamanëve me dimensione të përafërt 140x45cm (me dy thellësi) nga porcelani i klasit të I-rë me ngjyrë të bardhë. Në çmim përllogaritet sifoni, baterija për ujë të ftohtë dhe ngrohtë me valvolë, perforcimi i lavamanit për mure, me të gjitha pjesët përcjellëse. Përllogaritja për copë të lavamanit të kompletuar.	copë	1	€ 225.00	€ 225.00
9.2	Furnizimi, transporti dhe montimi i wc-guacës prej porcelanit të klasit të I-re, komplet me kazanin për ujë me gyp për shperlarje Ø 5/4. Gjithashtu në çmim duhet llogaruar edhe "EK" valvola për lidhje të kazanit si dhe një krrua për pastrim. Në tërësi sipas përshkrimit teknik, detalit në projekt si dhe udhëzimeve të organit mbikqyrës. Përllogaritja për copë të komplet pozicionit të	copë	2	€ 75.00	€ 150.00
9.3	Furnizimi dhe montimi i bojlerit elektrik, me vëllim V=80 l.	copë	1	€ 80.00	€ 80.00
9.4	Furnizimi dhe montimi i pasqyreve me dimensione të përafërt 140x100cm. Në pozicion të përfshihet edhe materiali ngjitës.	copë	1	€ 60.00	€ 60.00
9.5	Furnizimi dhe montimi i Baterive (qeshme) të kualitetit të lart, me funksion për ujë të ngrohtë dhe të ftohtë, me të gjitha elementet përcjellëse për funksionalizim të plotë.	copë	2	€ 15.00	€ 30.00
9.6	Furnizimi transporti dhe montimi i fikëseve të zjarrit me shkumë e tipit MURAL 6 kg (TIPI 21A 113B). Komplet të vendosura në objekt. Të vendosen në vendet ku i cakton organi mbikqyrës	copë	2	€ 40.00	€ 80.00
				Nëntotali 9	€ 625.00

10	ELEKTRIKA				
10.1	Furnizimi dhe montimi i tabelës shpërndarëse elektrike për Përdhësë dhe katin e I (TSH1 dhe TSH2). Me mbrojtje IP43, 36 modulshe, me elemente përcjellëse.	copë	2	€ 80.00	€ 160.00
10.2	Furnizimi dhe montimi i mbrojtjes diferenciale katërploare me rryma normale In=25A dhe rryma diferenciale Idn=0.03A.	copë	2	€ 45.00	€ 90.00
10.3	Furnizimi dhe montimi i siguresave automatike njëpolare 1P+N me karakteristikë veprimi C për rryma nominale In=16A.	copë	48	€ 8.00	€ 384.00
10.4	Furnizimi dhe montimi i siguresave automatike njëpolare 1P+N me karakteristikë veprimi C për rryma nominale In=10A.	copë	12	€ 8.00	€ 96.00
10.5	Materiali i imët përcjellës për lidhje (zbarra, përques P/F, papuqe, kleme, bulona, etj.)	Paushall	1	€ 5.00	€ 5.00
	Furnizimi dhe montimi i kabllove energjetike	m'	50	€ 3.80	€ 190.00

10.6	Furnizimi dhe montimi i kabllove energjetike NYM-J 5x10mm ² , Cu.NEGOTIN ose te ngjashëm.	m'	32	€ 8.60	€ 275.20
10.7	Furnizimi dhe montimi i kabllove energjetike NYM-J 5x2.5mm ² .NEGOTIN ose te ngjashëm.	m'	23	€ 2.40	€ 55.20
10.8	Furnizimi dhe montimi i kabllove energjetike NYM-J 3x2.5mm ² .NEGOTIN ose te ngjashëm.	m'	340	€ 1.00	€ 340.00
10.9	Furnizimi dhe montimi i kabllove per ndriqim NYM-J 3x1.5mm ² .NEGOTIN ose te ngjashëm.	m'	410	€ 0.60	€ 246.00
10.1	Furnizimi dhe montimi i kabllove koaksiale	m'	300	€ 0.35	€ 105.00
10.11	Porosia , furnizimi dhe montimi i gypit të brinjëzuar PVC Ø 32mm.	m'	55	€ 0.20	€ 11.00
10.12	Furnizimi dhe montimi i gypit të brinjëzuar PVC Ø 20mm.	m'	750	€ 0.14	€ 105.00
10.13	Furnizimi dhe montimi, Gyp i brinjëzuar PVC Ø16mm.	m'	50	€ 0.11	€ 5.50
10.14	Furnizimi dhe montimi i trupit ndriçues LED 60x60cm , 45ë,3600lm, luminishent per montim ne plafon . Mbrojtja IP 20.Pagesa komplet per copë.	copë	42	€ 38.00	€ 1,596.00
10.15	Furnizimi dhe montimi i trupit ndriçues LED 120x30 45 ë, me mbrojtje IP65, me mbules opale polikarbonat, për montim direkt në plafon prej betoni.Pagesa komplet per copë.	copë	8	€ 38.00	€ 304.00
10.16	Furnizimi dhe montimi i trupit ndriçues LED me poç 1x10ë,me sensor te inkorporuar, IP65, për montim direkt në plafon prej betoni.Pagesa komplet per copë.	copë	4	€ 12.00	€ 48.00
10.17	Furnizimi dhe montimi i trupit ndriçues LED 1x20ë, për montim në mur ,IP65.	copë	5	€ 12.00	€ 60.00
10.18	Furnizimi dhe montimi i trupave ndriçues 1x8ë, emergjent luminishent per montim direct ne mur apo plafon.Me shtepize nga polikarbonati, me kapak PMMA, me bateri autonome 3h, nga NiCd me mbishkrimin e ngjitur.Mbrojtja IP 41, EXIT.	copë	4	€ 9.00	€ 36.00
10.19	Furnizimi dhe montimi i prizave monofazore për montim të mbrendshëm, 16A, së bashku me elementet përcjellëse	copë	100	€ 7.00	€ 700.00
10.2	Furnizimi dhe montimi i prizave trefazore për montim të mbrendshëm, 16A së bashku me elementet përcjellëse.	copë	2	€ 15.00	€ 30.00
10.21	Prizë njëfazore modulare me mbulesë, për favolina pune	copë	2	€ 22.00	€ 44.00
10.22	Furnizimi dhe montimi i prizave per TV	copë	2	€ 9.00	€ 18.00
10.23	Furnizimi dhe montimi i ndërprerësve të thjesht për montim të mbrendshëm, 16A, së bashku me elementet përcjellëse.	copë	17	€ 12.00	€ 204.00
10.24	Furnizimi dhe montimi i ndërprerësve alternativ për montim të mbrendshëm 16 me mbulesë.	copë	4	€ 12.00	€ 48.00
10.25	Furnizimi dhe shtrirja e kablilit UTP cat.6e. Prej prize deri ne bllokun komutues , neper gyp të PVC ne suva dhe beton. Paguhet komplet per m'	m'	440	€ 0.55	€ 242.00
10.26	Furnizimi dhe montimi i prizave RJ45 modulare. Paguhet komplet me lidhje dhe pllake me stikera per shenim te prize, si dhe matje dhe dhenja e protokollit per secilen prize.	copë	38	€ 8.00	€ 304.00
10.27	Furnizimi dhe montimi i patch paneleve 25 port cat.6e te tipit 110/RJ45. Shenimi i tyre sipas pershkrimit teknik. Paguhet komplet per cope dhe lidhje.	copë	2	€ 125.00	€ 250.00
10.28	Furnizimi dhe montimi i SëITCH-ave të menaxhueshem 25 port te tipit RJ45 dhe 25 porte optike sipas pershkrimit teknik,apo ndonje tip i ngjashem me karakteristika te tilla.Paguhet komplet per cope, lidhje dhe konfigurim.	copë	2	€ 150.00	€ 300.00
10.29	Furnizimi dhe montimi i patch cord-ave UTP cat.6 me gjatesi 1,5 dhe 3m, sipas pershkrimit teknik. Paguhet komplet per cope dhe lidhje.	copë	28	€ 5.00	€ 140.00
10.3	Material i nevojshem per montim (lidhese plastike per kablo, labela identifikuese, etj). Paguhet paushall.	Paushall	1	€ 5.00	€ 5.00
10.31	Furnizimi dhe montimi i tabelës shpërndarëse elektrike për Kalidas (KSHE-K) .Me mbrojtje IP43, për mbi mure 533x293x200, me këto elemente:	copë	1	€ 60.00	€ 60.00


10.33	Furnizimi dhe montimi i siguresave automatike trepolare me karakteristike veprimi C për rryma nominale In=16A	copë	1	€ 20.00	€ 20.00
10.34	Furnizimi dhe montimi i siguresave automatike trepolare 3P+N me karakteristike veprimi C për rryma nominale In=25A	copë	1	€ 20.00	€ 20.00
10.35	Furnizimi dhe montimi i siguresave automatike njepolare 1P+N me karakteristike veprimi C për rryma nominale In=16A	copë	3	€ 12.00	€ 36.00
10.36	RACK 600x600x6U , i kompletuar me ventilator PDU	copë	2	€ 180.00	€ 360.00
Nëntotali 10					€ 6,937.90

11	NGROHJA				
11.1	Furnizimi dhe montimi i radiatoreve tip 22				
	600/800	copë	2	€ 90.00	€ 180.00
	600/1000	copë	4	€ 110.00	€ 440.00
	600/1200	copë	6	€ 115.00	€ 690.00
	600/1400	copë	1	€ 130.00	€ 130.00
11.2	Furnizimi dhe montimi i valvolave me Termokokë DN 15	copë	13	€ 19.00	€ 247.00
11.3	Furnizimi dhe montimi i valvolave qe montohen ne dalje te radiatorit DN 15	copë	13	€ 15.00	€ 195.00
11.4	Furnizimi dhe montimi i Kolektor Ø 1"/ 6x1/2"	copë	2	€ 45.00	€ 90.00
11.5	Furnizimi dhe montimi i Kolektor Ø 1"/ 7x1/2"	copë	2	€ 50.00	€ 100.00
11.6	Furnizimi dhe montimi i Gypa Al-plast Ø16x2.0	m	260	€ 1.20	€ 312.00
11.7	Furnizimi dhe montimi i Gypa Al-plast Ø28x2.5	m	24	€ 1.90	€ 45.60
11.8	Furnizimi dhe montimi i Fitingu i gypave Al-plast				€ 0.00
11.9	Furnizimi dhe montimi i Kaseta 450x700	copë	2	€ 18.00	€ 36.00
11.1	Furnizimi dhe montimi i Valvola DN 25 me holander	copë	3	€ 15.00	€ 45.00
11.11	Furnizimi dhe montimi i Filter DN 25	copë	1	€ 18.00	€ 18.00
11.12	Furnizimi dhe montimi i Red DN 25/DN20	copë	2	€ 20.00	€ 40.00
11.13	Furnizimi dhe montimi i Kaldas elektrike kompakte, me pompe, ene			€ 0.00	€ 0.00
		copë	1	€ 1,250.00	€ 1,250.00
11.14	Furnizimi dhe montimi i Ventil per qajrosje DN 15	copë	4	€ 15.00	€ 60.00
11.15	Furnizimi dhe montimi i T-lidhje DN25/DN15/DN25	copë	4	€ 10.00	€ 40.00
11.16	Furnizimi dhe montimi i Ventil mbushje-zbrazje	copë	4	€ 19.00	€ 76.00
11.17	Furnizimi dhe montimi i Shqyrtimi i sistemit te ngrohjes	Paushall	1	€ 15.00	€ 15.00
11.18	Furnizimi dhe montimi i Mbushja me antifriz	litra	100	€ 2.40	€ 240.00
11.19	Furnizimi dhe montimi i Termostat digital per kontrollimin e temperatures	copë	1	€ 75.00	€ 75.00
Nëntotali 11					€ 4,324.60

Rikapitulim

1	PUNËT E DEMOLIMIT NË OBJEKT	€ 533.00
2	PUNËT E MUREVE	€ 1,225.00
3	PUNËT E SUVATIMIT	€ 8,960.00
4	PUNËT E DYSHEMESE	€ 8,685.00
5	PUNËT E ZDRUKHTARISE	€ 9,515.00
6	PUNËT E NGJYROSJES	€ 2,000.00
7	RRJETI I UJESJELLESIT	€ 343.00
8	RRJETI I KANALIZIMIT	€ 58.00
9	ELEMENTET SANITARE	€ 625.00
10	ELEKTRIKA	€ 6,937.90
11	NGROHJA	€ 4,324.60

TOTAL: € 43,206.50



ELSIG

Kompania e Sigurimeve Sh.A./Insurance Company J.S.C.

Gjithcka që duhet ta kenë

Deklaratë e Garantuesit

SIGURTA E EKZEKUTIMIT

Pjesë përberëse e Polices me Nr. 112865

Për KUVENDIN E KOMUNES SE PRISHTINES

(Emri i Autoritetit Kontraktues)

Në emër të MBB Construction SH.P.K.

(Emri dhe adresa e "Operatorit Ekonomik" dhe nr. i biznesit në vazhdim Operatori Ekonomik)

Titulli i aktivitetit të prokurimit: Renovimi dhe Invertarizimi i Shogates Qendrore të Personave të Shurdher LOR-I

Nr. prokurimit: 616-22-12893-5-2-1

Garancion me kërkesë të parë

Derisa operatori ekonomik i lartcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke luajtur garancion me numër të prokurimit të lartcekur të dorëzuar nga autoriteti kontraktues dhe ngase tenderuesi dëshiron të depozitojë garancion në shumën e saktesuar në dosjen e tenderit dhe ngase jemi pajtuar të japim tenderuesit këtë garancion.

Andaj me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një shumë totale 4,320,653 zotohemi të luajmë pagujmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mosperputhja e njërit nga kushtet në vijim:


- Autoriteti kontraktues konstaton në bazë të dëshmiave të vertetuara objekti vishet se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substanciale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në gjalë, dhe;
- Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbetur pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe/ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej 4,320,653 sic është lartcekur, pa pasur nevojë të vertetoni apo të tregoni arsye ose shkaqet e kërkesës tuaj, apo për shumën e specifikuar këtu.

Kjo siguri vlenë 395 ditë kalendrike prej 27.04.2023 deri më 26.05.2024

Data tëshimit: 27.04.2023

Nënshkrimi dhe vula e garantuesit



Ky garancion i nënshtrohet rregullave uniforme për garancione (URDG), botim 2010, Publikimi ICC Nr. 758



ELSIG

Gjithcka që duhet ta keni

Kompania e Sigurimeve Sh.A./Insurance Company J.S.C.

Kompania e sigurimeve ELSIG sh.a , Prishtinë, Adresa: Rr. "Tringë Ismajli"-nr,19,
Tel: +383 (0) 38 221 112; Fax: +383 (0) 38 221 115, E-mail: office@kselsig.com



POLICË PËR SIGURIMIN E GARANCISË SË EKZEKUTIMIT TË KONTRATËS

Nr. Polices: **112865**

Kontraktuesi	
Emri	MBB Construction SH.P.K.
Përfaqësuar nga	Kushtrim Bajrami
Adresa	CARALEVËS NR.81
Nr i Biznesit	810080432
Telefoni	045145245

Përfituesi	
Emri	KUVENDI I KOMUNES SË PRISHTINËS
Adresa	PRISHTINË

Garantuesi	
Emri	Elsig
Banka	NLB
Garantuesit	

Mbulueshmëria e Polices	
Shuma Siguruar	4,320.65
Periudha Sigurimit	27.04.2023 - 26.05.2024
Primi	84.16
Tvsh	15.15
Primi Bruto	99.31
Data e lëshimit	27.04.2023 12:10

Aktiviteti Ekonomik:
Renovimi dhe Invertarizimi i Shokatës Qendrore të Personave të Shurdhër. LOT 1.

Lënda e Garancisë

Detyrimet e Siguruesit ndaj Përfituesit sipas kësaj Police të sigurimit janë:

- Mbështetur në këtë Police - Garancie, Siguruesi / Garantuesi merre përsipër që të plotësojë çdo detyrim kontraktori i cili është i garantuar me këtë police.
- Përfituesi e ka të drejtën t'i drejtohet Siguruesit / Garantuesit për marrjen e dëmshpërblimit deri në shumën e garantuar, vetëm kur detyrimet kontraktuale nuk plotësohen për faj të të Siguruarit / Kontraktuesit - Ekzekutuesit të Kontratës.
- Me plotësimin e detyrimeve ndaj Përfituesit, Siguruesit/Garantuesit i lind e drejta që t'i drejtohet të Siguruarit/Kontraktuesit, me të gjitha mjetet ligjore, për të bërë rimbursimin e shpenzimeve të kryera në funksion të plotësimit të detyrimeve ndaj përfituesit (cedimi i të drejtave nga Përfituesi të Siguruesit/Garantuesit).
- Ky sigurim është lidhur sipas Kushteve të përgjithshme të Sigurimit të Garancive dhe ekzekutimit të kontratës të cilat janë pjesë përbërëse e kësaj Police.
- Për polica të sigurimit - Ekzekutimi i kontratave - pjesë përbërëse e kësaj police është kontrata e ekzekutimit të punëve ndërmjet autoritetit kontraktues (Përfituesi) dhe Operatori Ekzekutues (të Siguruarit) di dhe marrëveshja e lidhur në mes Siguruesit dhe Operatorit Ekonomik (hipoteka e lënë peng)

Me nënshkrimin e kësaj kontrate pajtohem që Kompania e Sigurimit ti ruaj të dhënat e mia personale / të dhënat e biznesit, të cilat do të përdoren nga Kompania për qëllime statistikore, hulumtim/raportim në Regjistrin Kreditor të Kosovës si dhe transferim tek një palë e tretë me qëllim të trajtimit të dëmeve.

Me nënshkrimin e kësaj police të sigurimit, nënkuptohet se unë i siguruari me vullnet të lirë, të barabartë dhe me mirëbesim kam pranuar primin e sigurimit, kam lexuar, kuptuar dhe pranuar kushtet e sigurimit.
My signature in this insurance policy signifies that I the insured with good will have accepted the insurance premium. I have read, understood and accepted the insurance terms and conditions



Kompania e Sigurimeve Elsig
Bajram Fazliu - 1940



Përfaqësuesi i të siguruarit
Kushtrim Bajrami